



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.330/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur lidhur me ankesën e Agim Vuniqit, nga Prishtina, paraqitur kundër Komisionit zgjedhor Të Kosovës (KQZ), për shkak të Mos lejimit të votimit në qendrën përkatëse, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e Agim Vuniqit, Anr.330/2019 e datës 06.10.2019, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me të cilin ka kërkuar arsyen përse është penguar që të votoj.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Agim Vuniqi, nga Prishtina, me datën 06.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 06.10.2019, në ora 16:30, në Qendrën e Vendvotimit, pika 1913E/09D, nuk i është lejuar që të votoj, dhe nga paneli i kësaj pike të vendvotimit ka kërkuar që me shkrim ti jepet ndalesa e votimit, në të cilën përgjegjës i kësaj pike ishte Lendrit Ramadani.

Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes.

Në përgjigjën në ankesë, të datës 07.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se ankesa është e pabazuar, ngase ankesa e palës është e pa precizuar, nuk ka përshkrim të mjaftueshëm për pohimet e tij, nuk e ka specifikuar arsyen e pengimit të tij që të votoj, gjithashtu nuk e ka precizuar se nga kush dhe për çfarë arsye është penguar që të votoj. Andaj KQZ, duke u bazuar në nenin 5 par.7, i Rregullores së PZAP-së, nr. 02/2015 konsideron se ankesa të Refuzohet.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale, të bashkangjitura, të cilat mungojnë në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.3 dhe neni 118 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret ankuesi përveç pretendimeve të parashtruara në ankesë, nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale për ti vërtetuar pretendimet e tij. Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 i LZP-ë, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.330/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani,



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.